

**OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË TREGUT**

Nr. 1892 prot.

Tiranë, më 23/03/2022

Lënda: Kërkesë për zgjatjen e periudhës së parashikuar në pikën 5 të Vendimit të ERE Nr.255, datë 21.12.2021.

**ENTIT RREGULLATOR TE ENERGJISE**  
Blvd. "Bajram Curri", Rruga "Viktor Eftimiu", nr. 1023, Tirane

**I nderuar Z. Ahmeti,**

Në vijim të shkresës tone nr.5977/7 Prot, datë 09.12.2021, ku në kushtet e shpalljes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, në zbatim të VKM nr. 584 date 08.10.2021, OST ka qenë e detyruar të pezullojë investimet e parashikuara për vitin 2021, duke krijuar po ashtu dhe ngadalësim të procesit të implementimit në platformën elektronike DAMAS të specifikimeve që reflektojnë përmbushjen e parashikimeve të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e ERE Nr. 106, Datë, 02.07.2020.

Duke marr në konsideratë dhe kohën e nevojshme të zhvillimit të procedurës për procesin e implementimit në platformën elektronike DAMAS të gjithë specifikimeve të nevojshme konform rregullave ne fuqi, dhe të gjetur në kushtet e mos miratimit të planit të investimeve për vitin 2022. OST vlerëson që nevojitet një periudhë më gjatë për ta finalizuar këtë proces të rendësishëm për operimin e tregut balancues.

Për gjithë sa më sipër, OST kërkon mirëkuptimin tuaj për miratimin e zgjatjes së periudhës së parashikuar në pikën 5 të Vendimit të ERE Nr.255, datë 21.12.2021 deri në datën 31 Dhjetor 2022.

Mbetemi të hapur për çdo sqarim të mëtejshëm, duke shpresuar se propozimi ynë do të merret në konsideratë prej jush.

Me respekt,

**ADMINISTRATORI I OST SH.A.**  
  
**Skerdi Drenova**  
OPERATORI I SISTEMIT  
TE TRANSMETIMIT